



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**RREGULLORE (QRK) - NR. 32/2024 PËR THEMELIMIN,
FUNKSIONIMIN, ORGANIZIMIN DHE MONITORIMIN E QENDRAVE
PËR ZHVILLIM RAJONAL NË RAJONET ZHVILLIMORE¹**

Rregullore (QRK) Nr. 32/2024 për Themelimin, Funkcionimin, Organizimin dhe Monitorimin e Qendrave për Zhvillim Rajonal në Rajonet Zhvillimore, është miratuar në mbledhjen e 223-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 11/223, të datës 09.10.2024.¹

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93, të paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 19, paragrafit 1.2, të Ligjit nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/7 gusht 2023), nenit 8, paragrafit 4 (4.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Miraton:

RREGULLORE (QRK) - NR. 32/2024 PËR THEMELIMIN, FUNKSIONIMIN, ORGANIZIMIN DHE MONITORIMIN E QENDRAVE PËR ZHVILLIM RAJONAL NË RAJONET ZHVILLIMORE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton mënyrën e themelimit, organizimit, funksionimit dhe monitorimit të punës së Qendrave për Zhvillim Rajonal në shtatë (7) Rajonet Zhvillimore të Kosovës në lidhshmëri me zbatimin e dispozitave të neneve 16 dhe 17 të Ligjit NR.08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar.
2. Kjo rregullore është në përputhshmëri me Rregulloret e BE-së 1299/2013, 1301/2013 dhe 1303/2013.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për Qendrat për Zhvillim Rajonal në rajonet zhvillimore përkatëse.

KAPITULLI II

QENDRAT PËR ZHVILLIM RAJONAL

Neni 3

Themelimi i Qendrave për Zhvillim Rajonal

1. Në përputhje me Nenin 6, përkatësisht pikën 1 dhe 2 të Ligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar Qendrat për Zhvillim Rajonal janë trupa përgjegjëse për zhvillim rajonal të balancuar të cilat themelohen bazuar në nenin gjashtëmbëdhjetë (16) të Ligjit përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Ligjit përkatës për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe kriterin NUTS të përcaktuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

2. Qendrat për Zhvillim Rajonal bazuar në paragrafin 1 të këtij neni themelohen në shtatë (7) rajone zhvillimore në bazë të marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit ndërkomunal, sipas klasifikimit NUTS-3 të përcaktuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

3. Procesi i Marrëveshjeve për Bashkëpunim Ndërkomunal do të bashkërendohet nga Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal, Ministria përgjegjëse e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunitat bazuar në paragrafin 1 të Nenit 3.

Neni 4

Funksionimi

1. Qendrat për Zhvillim Rajonal funksionojnë mbi bazën e marrëveshjes të dalë në përputhje me Ligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Ligjin përkatës për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe kriterin NUTS. Bazuar në kriterin NUTS Qendrat për Zhvillim Rajonal operojnë në shtatë rajone zhvillimore.

2. Rajonet Zhvillimore janë të harmonizuara me Rajonet Statistikore (shih shtojcën nr. 1).

Neni 5

Organizimi

1. Organizimi i Qendrave për Zhvillim Rajonal përcaktohet me Marrëveshjet e Bashkëpunimit Ndërkomunal.

2. Qendrat për Zhvillimit Rajonal do të sigurojnë stafin përkatës për zbatimin e detyrave të përcaktuara me marrëveshjet e bashkëpunimit dhe partneritetit në mes institucioneve dhe trupave përgjegjëse për zhvillim rajonal të balancuar në shtatë (7) rajonet zhvillimore, në përputhje me Neni 14 të Ligjit Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

Neni 6

Fushëveprimtaria e Qendrave për zhvillim rajonal

1. Fushëveprimtaria e Qendrave për zhvillim rajonal në lidhje me zbatimin e dispozitave të këtij ligji është përcaktuar si vijon:

1.1. Mbështetje në procesin e hartimit të politikave dhe programeve për zhvillim rajonal të balancuar si dhe planeve të tyre përkatëse të zbatimit Konform Ligjit përgjegjës për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

1.2. Koordinimi i procesit të hartimit të Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal të rajoneve përkatëse zhvillimore dhe mbështetja e njësive të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me Ligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

1.3. Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve dhe mbështetja e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve tjera që veprojnë në rajonet përkatëse zhvillimore në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim realizimin e Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal në rajonet zhvillimore.

1.4. Mbështetja e organizatave të sektorit privat në rajonet përkatëse zhvillimore, në avancimin e kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit të projekteve investuese, me qëllim të shfrytëzimit më efikas të mundësive për mbështetje financiare nga programet qeveritare dhe donatorëve, me qëllim të krijimit të mundësive për zhvillim ekonomik.

1.5. Grumbullimi i të dhënave statistikore dhe informatave tjera relevante nga institucionet përgjegjëse për rajonet përkatëse zhvillimore të cilat janë të nevojshme për matjen e ndryshimeve tek indikatorët socio-ekonomik të ndërlidhur me zhvillimin rajonal të balancuar të cilat shfrytëzohen për proceset e raportimit dhe të planifikimit.

KAPITULLI III KRITERET E FINANCIMIT, MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Neni 7 Planifikimi i mbështetjes financiare

1. Financimi i shpenzimeve operative të Qendrave për Zhvillim Rajonal në lidhshmëri me zbatimin e fushëveprimit nga Neni 6 i kësaj rregulloreje, bëhet në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partneritetit në mes institucioneve dhe trupave përgjegjëse për zhvillim rajonal të balancuar në shtatë (7) rajonet zhvillimore, në përputhje me Neni 14 të ligjit, si dhe me pikën 1.10 të Nenit 15 të Ligjit Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

2. Marrëveshjet nga pika 1 e këtij neni përcaktojnë përqindjen e pjesëmarrjes në financimin e shpenzimeve të Qendrave për Zhvillim Rajonal nga ana e Ministrisë përgjegjëse për zhvillim rajonal bazuar në planet operacionale të shtatë (7) rajoneve zhvillimore, si dhe donatorëve të tjerë nëse të tillë identifikohen.

Neni 8 Monitorimi

1. Njësia përgjegjëse për Zhvillim Rajonal, monitoron në baza periodike zbatimin e planeve operacionale të aprovuara nga Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal.

Neni 9
Raportimi

1. Qendrat për zhvillim rajonal në rajonet zhvillimore përkatëse obligohen që më së largu deri me 31 Mars të vitit pasues të raportojnë në Ministrinë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal dhe te Bordi Drejtues për implemetimin e planit operacional të vitit paraprak.
2. Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal dhe Komunitet e Rajonit Zhvillimor përkatës mund të kërkojnë dhe raportim tjera në baza periodike.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

20 dhjetor 2024

Shtojca Nr. 1

Rajonet Zhvillimore	Kodimi dhe etiketimi i rajoneve statistikore në Kosovë	
	Kodi	Niveli 3
Rajoni Qendër	XK001	Prishtinë
Rajoni Veri	XK002	Mitrovicë
Rajoni Perëndim	XK003	Pejë
Rajoni Jug	XK004	Prizren
Rajoni Juglindje	XK005	Ferizaj
Rajoni Lindje	XK006	Gjilan
Rajoni Jugperëndim	XK007	Gjakovë

